

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 23818 . Akt

V E N D I M
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 16.12.2002, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane
M. Qeda, si shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga Ministria e
Ekonomise Publike dhe Privatizimit per rregjistrimin e shoqerise tregtare "Kripa"
Vlore.

KONSTATOVA SE :

Kerkuesi Ministria Ekonomise Publike dhe Privatizimit ka paraqitur kerkesen per te
rregjistruar si person juridik shoqerine ne formen e nje shoqerie anonime "Kripa"
Vlore me kohezgjatje pa afat te caktuar, me aksioner te vetem Mnistrine Ekonomise
Publike dhe Privatizimit, me kapital themeltar 5.160.000.000 leke ndare ne
5.160.000 aksione, me vlere nominale 1000 leke, me objekt veprimtarie: Nxjerrje,
perpunim jodizim kripe, prodhim , shperndarje , eksport kripe.
Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti, urdheri nr.46 date 5.10.1999
te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit dhe kerkesa per miratim
eksperti jane te plota dhe te bazuara ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", si dhe nenit 33
ligjit Nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen
plotesuar ne te".

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "Kripa" Vlore me kohe zgjatje
pa afat te caktuar me kapital themeltar 5.160.000.000.leke me aksioner te vetem
Ministrine e Ekonomise Publike me objekt veprimtarie : Nxjerrje, perpunim jodizim
kripe, prodhim , shperndarje , eksport kripe.

Keshilli mbikqyres perbehet nga :

- Z. Sokol Fshazi
- Zj. Olimbi Myshkeri
- Z. Arqile Lici

Kunder vendimit lejohet ankimi ne shkalle te dyte.

GJYQTARE
Marianus Jeda.
Dedez

AKT -THEMELIMI I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime " Kripa" Sh.A Vlore.
2. Objekti i shoqerise eshte:
Nxjerrje, perpunim jodizim kripe, prodhim shperndarje eksport kripe..
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane dhe ajo mund te çele dege, filiale agjenci dhe perfaqesi ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 5.160.000.000.leke ndare ne5.160.000 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
Z. Sokol FSHAZI
Zj Olimbi MYSHKERI
Z. Arqile LICI
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

